

BULETINI I TRAFIUKUT AJROR

PRISHTINA INTERNATIONAL AIRPORT
ADEM JASHARI
KONTROLLI AJROR

NUMËR I

16.05.2013

MESAZHI I
KRYESHEFIT
EKZKETUV
Z.BAHRI
NUREDINI

Faqe 2

Ç FAR ËSHTË
“ I C A O ”
ORGANIZATA
NDËRKOMBË
T A R E E
AVIACIONIT
CIVIL?

Faqe 5

SI TË KAPËR-
CENI FRIKËN
E
FLUTURIMIT,
JA 3 MËNYRA

Faqe 6

ANP MODERNIZON HAPËSIRËN AJRORE



Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës – Kontrolli Ajror “Adem Jashari”, në kuadër të përmbushjes së standardeve ndërkombëtare siç janë ICAO dhe EUROCONTROL-i për një qiell të përbashkët evropian, si dhe me qëllim të realizimit të detyrimeve për certifikim si Ofrues i Shërbimeve të Navigimit Ajror, është në fazën përfundimtare të realizimit të projektit madhor për Modernizimin e Hapësirës Ajrore të Republikës së Kosovës.

Kryeshefi Ekzekutiv i ANP-Kontrolli Ajror “Adem Jashari” Bahri Nuredini, realizimin e këtij projekti e

cilësoi të një rëndësie të madhe dhe të domosdoshëm për shërbimet që ofron ANP-ja.

“Ky projekt i cili përmban një numër të madh të investimeve kapitale

vijon në faqen 2



EUROCONTROLI ÇERTIFIKON 20 ZYRTAR TË ANP-së

Shërbime të Navigimit Ajror i EUROCONTROL-it (IANS), në bashkëpunim me ANP – Kontrolli Ajror “Adem Jashari”, 20 punonjës të ANP-së kanë marrë certifikata nga EUROCONTROL-i, në prgramin e Vlerësimit Preliminar të Sistemeve të Sigurisë.

vijon në faqen 3

METEOROLOGJIA
AERONAUTIKE, PJESË
E RËNDËSISHME E
OPERIMEVE NË ANP
“ADEM JASHARI”

faqe 4

MBI 17% RRITET
NUMRI I OPERIMEVE
NË ANP “ADEM
JASHARI”

faqe 5

Pas një trajnimi dyjavor i cili është mbajtur në Prishtinë dhe është organizuar nga Instituti për

**MESAZHI I KRYESHEFIT
EKZEKUTIV**



Është privilegj i imi të udhëheq ANP "Adem Jashari" Sh.A. në këtë fazë të tranzicionit dhe për të qenë pjesë e zhvillimeve, gjegjësisht të krijimit të një agjencioni për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror.

Viti 2012 për ANP-Kontrolli Ajror "Adem Jashari" Sh.A. shënon një vit të suksesshëm të ushtrimit të aktivitetit të pavarur si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror në Hapësirën e Republikës së Kosovës.

Si objektivi i yni gjatë kësaj periudhe ka qenë ofrimi i shërbimeve më të mira për klientët pa kushtëzime nga kërkesat e larta për siguri në fluturim, njëkohësisht ky do të jetë edhe objektivi ynë kryesor në të ardhmen.

Në planin afatshkurtër, qëllimi ynë është që të zvogëlojmë kostot duke lënë për më vonë projektet e planifikuara e që kanë prioritet më të vogël dhe duke u bërë më eficient në punën tonë të përditshme.

Në planin afatgjatë, ne planifikojmë që të hyjmë në aleanca për aktivitete të përbashkëta me organizatat tona simotra. Qëllimi ynë është që të krijojmë ekonominë e shkallës për të

ruajtur nivelin e tanishëm të lartë të sigurisë dhe në të njëjtën kohë për të zhvilluar aktivitete më të efektshme që na mundësojnë për të përmbushur më herët nevojat që paraqiten para nesh.

Në përgjithësi jemi të fokusuar në jetësimin e projektit madhor të lëshimit në funksion të mbifluturimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës si dhe në implementimin e kërkesave të AACK-së dhe autoriteteve tjera përkatëse, e që kanë të bëjnë me eliminimin e nënkonformiteteve të konstatuara nga Auditorët e AACK-së, krejt kjo me qëllim që të jemi të përgatitur për certifikim si ofrues i shërbimeve të navigimit ajror.

Në fund, më lejoni të përcjell një falënderim të sinqertë në emër të anëtarëve të menaxhmentit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" Sh.A., për të gjithë punëtorët e vyeshëm të ANP-së, dhe të gjithë ata që me bashkëpunimin dhe angazhimin e tyre kontribuuan në përmbylljen me sukses të vitit 2012

Dua të falënderoj Bordin e Drejtorëve të ANP "Adem Jashari" Sh.A., për përkrahje të vazhdueshme dhe inkurajuese për projektet dhe punën e menaxhmentit ekzekutiv të ANP-së.

Një mision ende e kemi përpara dhe ky mision është përkushtimi më i madh dhe profesionalizmi më i lartë në mënyrë që të arrijmë mbrojtjen, zhvillimin dhe të ngrisim edhe më tutje vlerën e kompanisë.

**Me respekt,
Kryeshefi Ekzekutiv
Bahri Nuredini**

MISIONI

Misioni i ANP-Kontrolli Ajror "Adem Jashari" është të siguroj shërbime cilësore në përputhje me standardet ndërkombëtare të trafikut ajror dhe sigurinë e fluturimeve në Hapësirën Ajrore të Republikës së Kosovës, me cilësi të lartë duke mos cenuar mjedisin, si dhe të kontribuoj në kërkesën e sigurisë së lartë në Hapësirën Ajrore atë Kosovës.

VIZIONI

Vizioni ynë është të bëhemi një ofrues i certifikuar i shërbimit të navigimit ajror sipas kërkesave të paraqitura nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës conform standardeve ndërkombëtare të EUROCONTROL dhe ICAO.

EUROCONTROLI ÇERTIFIKON 20 ZYRTAR TË ANP-KONTROLI AJROR

(vijon nga ballina)

Kryeshefi Ekzekutiv i ANP-Kontrolli Ajror "Adem Jashari" Bahri Nuredini, e vlerësoi lartë çertifikimin e stafit të ANP-së, duke theksuar se ky trajnim do të ndikoj në mënyrë direkte në ofrimin e shërbimeve më të mira në aspektin e cilësisë dhe sigurisë.

"Çertifikimet e tilla përveç që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve më cilësore nga ana e ANP-së, janë edhe të detyrueshme pasi që ne jemi në fazën e certifikimit si Ofrues i Shërbimit të Navigimit Ajror", theksoi Nuredini.

Sipas Nuredinit, ndër kushtet shumë të rëndësishme që duhet përmbushur për t'u certifikuar si Ofrues i Shërbimeve të Navigimit Ajror është edhe posedimi i një stafi operativ dhe teknik të trajnuar në fushat përkatëse sipas standardeve kombëtare të përcaktuara



nga Autoriteti i Aviacionit Civil që bazohen në kërkesat ndërkombëtare të përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO).

Më tej ai potencoi se, e mira e mbajtjes së këtyre trajnimeve në Kosovë nga Eurocontrol-i është se, shpenzohen shumëfish më pakë mjete dhe trajnohen numër më i madh i stafit njëherësh.

Nga ana tjetër trajnuesi, Jean-Francois Piriou i cili është Eksperti i Sigurisë nga Eurocontrol-i, u shprehë mjaft i kënaqur me motivin e stafit të cilët kanë marrë pjesë në trajnim dhe theksoi

se është shumë i sigurt se stafi i certifikuar njohuritë e marra nga ky trajnim do ti zbatojnë me përpikëri edhe në praktikë.

Armend Vërbovci Menaxher i Departamentit për Cilësi dhe Siguri në ANP, i cili u certifikua nga Eurocontrol-i, theksoi se, "sot kemi përfunduar ciklin e dytë të trajnimeve të ofruara në Kosovë nga Eurocontrol-i në fushën e Vlerësimit Preliminar të Sigurisë së Sistemeve dhe Procedurave të ANP-Kontrolli Ajror "Adem Jashari". Dobia e vijimit të këtij trajnimi është se, këto trajnime do të mundësojnë që stafi i ANP-

së të kryej Vlerësimet e Sigurisë se Sistemeve dhe Procedurave duke përdorur resurset njerëzore vetanake". "Kryerja e vlerësimeve të sigurisë mbi të cilat tashmë ANP "Adem Jashari" posedon staf të certifikuar do të përmbushë kërkesat ligjore që janë konform Legjislacionit Evropian në fushën e aviacionit civil, që rrjedhimisht rezulton në ngritjen e nivelit të sigurisë së ofrimit të shërbimeve aeronautike për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës", u shpreh Vërbovci.

Pjesëmarrës në këtë trajnim kanë qenë edhe 10 pjesëtarë nga Tirana përkatësisht nga Agjencia Nationale e Trafikut Ajror, kurse në vazhden e këtyre trajnimeve në muajt e ardhshëm një pjesë e stafit të ANP-së do t'i mbajë trajnimet në Tiranë, për programin ATSEP.



ANP DHE TEMPULLI NËNSHKRUAN MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Aeroporti Ndërkombëtar të Prishtinës – Kontrolli Ajror "Adem Jashari" dhe Shkolla e Lartë Profesionale Tempulli kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi me qëllim të vazhimit të ngritjes profesionale dhe zhvillimit të standardeve profesionale të të dyja institucioneve.

Ky Memorandum Bashkëpunimi, nga palët nënshkruese u cilësua si mjaftë i rëndësishëm, pasi që me këtë palët do të ndihmojnë në vendosjen e skemës së ndërsjellë përmes së cilës punëtorët e zgjedhur të ANP-Kontrolli Ajror "Adem Jashari" do të vijojnë aktivitetet sipas kërkesës në Shkollën e Lartë Profesionale Tempulli (SHLPT), nga ana tjetër studentët e zgjedhur të SHLPT-së do të vijojnë aktivitetet sipas kërkesës në ANP, ku qëllim i këtyre aktiviteteve është kusht për zhvillimin profesional dhe edukativ.

Në kuadër të kësaj marrëveshje SHLPT-ja, me

që është institucion i lartë arsimorë i akredituar dhe i licencuar, për ANP-në do të ofrojë programe profesionale trajnuese dhe akademike sipas kërkesave të ANP-së, duke sjellë ekspert në fushën e transportit ajror, psotës dhe telekomunikacionit si dhe logjistikës, kurse për studentët e SHLPT-së, ANP-ja do të ofroj punë praktike sipas nevojave dhe kërkesës së SHLPT-së.

Me këtë memorandum, ANP – Kontrolli Ajror "Adem Jashari", edhe njëherë dëshmon përkushtimin e menaxhmentit për ngritjen e kapaciteteve profesionale të cilat ndikojnë direkt në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore.

METEOROLOGJIA AERONAUTIKE, PJESË E RËNDËSISHME E OPERIMEVE NË ANP “ADEM JASHARI”



Nga Sherif Gosalci

Meteorologjia është shkencë që merret me studimin e atmosferës së tokës, aplikimi i së cilës është analiza dhe parashikimi i motit. Meteorologjia aeronautike studion atmosferën, meqë operimet aeronautike afektohen dhe zhvillohen në atmosferë.

Kushtet atmosferike mund të paraqesin rrezik por edhe mund të ndihmojnë në realizimin e fluturimeve. Shtrëngatat, turbulencat, ngricat, mjegulla, bora, e breshëri janë disa nga rreziqet potenciale që hasen në fluturim.

Departamenti Meteorologjik është një nga katër departamentet operative, qenësore, për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) “Adem Jashari”.

Departamenti Meteorologjik në ANP “Adem Jashari” është përgjegjës për vrojtimin dhe parashikimin e motit për nevojat e aviacionit, dhe për të përgatitur të dhëna klimatologjike dhe statistike të rëndësishme për planifikimin e operimeve aeronautike.

Objektivë e Departamentit Meteorologjik është ofrimi i informatave të nevojshme dhe të domosdoshme meteorologjike aeronautike tek shfrytëzuesit aeronautik, me qëllim të planifikimit të fluturimeve të rregullta dhe të sigurta.

Ky departament menjëherë pas luftës në Kosovë (1999) ka filluar konsolidimin dhe profesionalizimin e stafit, ku me ardhjen e Forcave Ajrore Mbretërore Britanike (RAF) në Aeroportin e Prishtinës është bërë edhe përzgjedhja e stafit.

Në periudha të ndryshme stafi i këtij departamenti është trajnuar dhe përgatitur profesionalisht në qendra të njohura ndërkombëtare në sferën e meteorologjisë aeronautike në Britani të Madhe, Francë, Islandë, Luksemburg, etj.

Sot, duke iu falënderuar sistemeve që kemi në shfrytëzim si ai për matjen e parametrevë meteorologjike – AWOS, për njoftimin e pilotëve – SADIS, për pranimin e imazheve dhe produkteve nga EUMETSAT (Organizata Evropiane për Eksplorimin e Imazheve Satelitore), sistemin e sondazhës – për matjen e parametrevë meteorologjike vertikalisht për qëllime të rritjes së efikasitetit në parashikim, si dhe stafit profesional që posedon, Departamenti Meteorologjik i ANP-së është shembulli i simotrave në rajon.

Gjithnjë duke përmbushur dhe respektuar kriteret dhe obligimet që rrjedhin nga

organizatat ndërkombëtare ICAO (Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil) dhe WMO (Organizata Botërore e Meteorologjisë), sot Departamenti Meteorologjik ofron shërbime 24 orë pandërprerë dhe si rezultat i kësaj, niveli i sigurisë i operimeve për dhe nga ANP “Adem Jashari” është i një standardi mjaft të lartë.

Për përmbushjen e këtyre të arriturave që u theksuan më lartë, ky departament përgatitë dhe shpërndan këto produkte: METAR – raporte të vrojtimeve që pasqyrojnë kushtet aktuale të motit, TAF (parashikimet aeroportuale) – parashikim i koduar aeronautik për ANP “Adem Jashari”; parashikime ditore për shtat ditë në vazhdim; seksioni i tërthortë – nga niveli sipërfaqësorë deri në 15 km lartësi; parashikimi rajonal - që përfshinë një diametër prej 35 km; paralajmërimet e aerodromit (Aerodrome Warning) në rast të kushteve jo të përshtatshme të motit për operime aeronautike duke u bazuar në kriteret; ditari i vëzhgimeve meteorologjike; si dhe përmbledhjet periodike vjetore dhe pesë vjeçare të të dhënave klimatologjike dhe statistike.

Të gjitha këto produkte të domosdoshme operative janë në shfrytëzim të pilotëve në çdo moment por dhe udhëtarët gjatë

fluturimit për në Prishtinë vazhdimisht informohen nga ekuipazhi i avionëve për kushtet e motit në ANP.

Bazuar në pozitën gjeografike të ANP-së dhe lëvizjen e ujërave mbi dhe përreth ANP-së, ballafaqimi me kushte specifike të motit është i pashmangshëm. Konditat ekstreme si, mjegulla, temperaturat ekstreme të ulëta dhe të larta sezonale dhe ditët e numërta me bubullima janë karakteristika që ndikojnë në sigurinë e operimeve.

Ndryshimet klimatike në dekadën e fundit pa dyshim kanë afektuar edhe vendin tonë. Interesimi i opinionit publik në lidhje me këto ndryshime gjithnjë e më tepër është në rritje, andaj përmbledhjet klimatologjike dhe statistikat e të dhënave meteorologjike të përgatitura nga Departamenti Meteorologjik i ANP “Adem Jashari”, përveq shfrytëzimit për nevojat aeronautike, gjithnjë e më tepër po rezultojnë me interesim të institucioneve të vendit për qasje në këtë pasuri, me qëllim të realizimit sa më të suksesshëm të projekteve madhore për vendin tonë.

(Autori është Menaxher i Departamentit Meteorologjik në ANP “Adem Jashari”)

Ç`FAR ËSHTË ICAO (ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E AVIACIONIT CIVIL)?

Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil është një agjenci e pavarur e Kombeve të Bashkuara që merret me zhvillimin e parimeve dhe teknikave të vozitjes ajrore ndërkombëtare, të shtigjeve ajrore dhe të aeroporteve si dhe promovon hartimin dhe zhvillimin e transportit ajror ndër- kombëtar për ta




Organizata e Aviacionit Civil Ndërkombëtar (The International Civil Aviation Organization "ICAO"), kodifikon principet dhe teknikat e navigimit ajror ndërkombëtar dhe kujdeset për planifikimin dhe zhvillimin e transportit ndërkombëtar për të bere një rritje të sigurte dhe të rregullt të këtij transporti. Zyrat

qendrore janë të lokalizuara në Quartier International of Montreal, Canada.

Këshilli i ICAO adopton standardet dhe praktikën e rekomanduara që i përkasin navigimit ajror, parandalon ndërhyrjet e paligjshme gjatë këtij procesi dhe ndihmon në procedurat e kalimit të kufijve për aviacionin civil ndërkombëtar. Gjithashtu ICAO përcakton protokollet që i përkasin hetimeve të aksidenteve ajrore të ndjekura nga autoritetet për sigurinë ajrore në shtetet që kanë firmosur Konventën e Aviacionit Civil që ndryshe njihet si Konventa e Chigago-s

Kosova nuk është antare e ICAO-së, mirëpo të gjitha ligjet i ka të harmonisuara me rregulloret dhe direktivat e ICAO-së

MBI 17% RRITET NUMRI I OPERIMEVE NË ANP "ADEM JASHARI"



Në periudhën janar-mars 2013 në ANP-Kontrolli Ajror "Adem Jashari" ka pasur një ngritje të ndjeshme të trafikut në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjatë tremujorit të parë të

vitit 2013 janë realizuar gjithsejtë 5,013 operime, ku në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2012 vërehet një ngritje e ndjeshme e numrit të operimeve, me që në periudhën TM1 2012 janë realizuar 4,282 operime, ku

në përqindje i bie që të kemi një rritje prej 17.08 % në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nga gjithsejtë 5,013 operime gjatë kësaj periudhe, 3437 kanë qenë Operime të Menaxhuara Komercale,

ndërkaq Operimet e Menaxhuara Ushtarake e përbëjnë shifrën prej 294 operimeve, kurse Operime tjera (VFR) gjatë kësaj periudhe janar-mars 2013 kanë qenë 1282 operime. Kompanitë që më së shumti patën operime gjatë kësaj periudhe kanë qenë Adria Airways me gjithsejtë 249 operime, e pasuar nga Belleair Europe me 217, Germanwings me 163, Darwin Airlines 149 si dhe Austrian Airlines me 124 operime në periudhën janar-mars 2013.

ANP MODERNIZON HAPËSIRËN AJRORE TË KOSOVËS



(vijon nga ballina)

-brenda vetës, është i domosdoshëm në mënyrë që të jemi në nivel me rekomandimet e EUROCONTROL-it, pasi që ne jemi në prag të certifikimit nga Autoriteti i Aviacionit Civil si dhe në përgatitje e sipër të hapjes së Hapësirës së Lartë Ajrore të Kosovës”, theksoi Nuredini. Sipas Kryeshefit Nuredini, edhe pse realizimi i këtyre projekteve kapitale mbart në vete një kosto jo të ulët të realizimit, në të ardhmen do të jenë fitimprurës dhe do të ndikoj direkt në rritjen e cilësisë së shërbimeve të ANP “Adem Jashari” si dhe janë të domosdoshme për operimin e Hapësirës së Lartë Ajrore të Kosovës. Projekti i Modernizimit të Hapësirës Ajrore përmban në vete disa nënprojekte kapitale siç janë: Zhvendosja e sistemeve ekzistuese të RADAR-it primar dhe sekondar si dhe pajisjeve tjera përcjellëse, procedurat STAR dhe SID të cilat

nënkuptojnë hapjen e rrugëve të reja ajrore, blerja e RADAR-it të ri, Sistemeve të Komunikimit të Follurit, Sistemeve të Navigimit si dhe blerja e Sistemit të Incizimit të Zërit, rilokimin apo blerjen e pozitive operuese në kullë.

ANP-së I DUHEN EDHE 15 MILION EURO PËR HAPËSIRËN AJRORE

Kryeshefi Bahri Nuredini theksoi se, për realizimin e gjitha projekteve të cilat janë të nevojshme për hapjen e Hapësirës së Lartë Ajrore janë parapa investime kapitale të nevojshme që kapin vlerën e 15 milion eurove, mjete këto të cilat ANP-ja nuk mund ti siguroj tani për tani, por shpreson që të gjejnë mbështetje tek Institucionet Relevante të Kosovës apo edhe nga organizmat ndërkombëtarë.

I gjithë ky projekt pritet të implementohet brenda vitit 2013, pasi që një pjesë e konsiderueshme e realizimit të tij varet edhe me përfundimin e punëve në kullën e re ku janë procedura standarde gjatë zhvendosjes së sistemeve nga kulla e vjetër në të rene me ç`rast puna e operimeve nuk duhet të ndërpritet për asnjë moment.

Projekti në fjalë duke përfshirë edhe trajnimet e stafit që është e domosdoshme për përdorimin e sistemeve të reja si dhe rilokimin e sistemeve ekzistuese dhe instalimin e sistemeve të reja ANP-së, ka një kosto rreth tetë milion euro. Gjithashtu ka përfunduar edhe projekti për modernizimin e sistemit ATIS i cili mundëson komunikimin automatik me pilotin, pasi që ka kaluar jetëgjatësinë e përdorimit. Ndërkaq për Hapësirën e Lartë Ajrore janë parapa edhe disa investime tjera

kapitale shumë të rëndësishme siç është Sistemi i Automatizimit ATM, ku parashihet ndërtimi i infrastrukturës së domosdoshme për një Qendër të vet të Kontrollit të Trafikut Ajror Regjional, në mënyrë që Kosova vet të menaxhoj me trafikun që kalon në hapësirën e saj ajrore, si dhe projektin e Sistemit të Radiokomunikimit Tokë - Ajër.

Gjithashtu në kuadër të ngritjes së cilësisë së shërbimeve ANP-ja ka organizuar edhe një varg trajnimesh nga ana e EUROCONTROL-it, duke përfshirë, trajnimin e kontrollorëve ekzistues, shkollimin e tetë kontrollorëve të rinj, trajnimin e stafit teknik në programin ATSEP si dhe certifikimin e 20 punonjësve nga EUROCONTROL-i në programin e Vlerësimit Preliminar të Sistemeve të Sigurisë i cili është mbajtur për herë të parë në Kosovë.

Në zbatim të Ligjit për Ndërmarrjet Publik përkatësisht të nenit 29 të këtij ligji, i cili parasheh realizimin e testit për nivelin e kënaqësisë së konsumatorit me shërbimet e ofruara nga Ndërmarrjet Publike, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës – Kontrolli Ajror “Adem Jashari”, hartuar një pyetësorë me anë të të cilit ka bërë vlerësimin e kënaqësisë së klientëve me shërbimet e ofruara nga ANP-ja.

Gjatë vitit 2012 në ANP-Kontrolli Ajror “Adem Jashari” janë kryer 20,156 operime, operime këto të cilat janë të ndara në tri kategori, atë të operimeve komerciale, ushtarake dhe operimeve tjera (VFR).
 Operime Komerciale – 14509
 Operime ushtarake -- 1304
 Operime tjera (VFR) – 4343
 Sipas të dhënave të paraqitura në figurën nr.1, vërehet se përqindjen më të madhe të operimeve në ANP “Adem

Jashari” gjatë vitit 2012 e kanë zënë Operimet Komerciale me 71.98%, Operimet Ushtarake 6.47% dhe operimet tjera (VFR) 21.55%.
 Në bazë të kësaj performance operative është bërë edhe realizimi i pyetësorit ku gjatë realizimit të testit për kënaqësinë e konsumatorit janë intervistuar klientët të cilët kanë pas më së shumti operime gjatë vitit 2012, përkatësisht klientët të cilët kanë përbërë rreth 30 përqind të të






Fig.1. Operimet gjatë vitit 2012





SI TË KAPËRCENI FRIKËN E FLUTURIMIT, JA 3 MËNYRA

Marrje mendsh, vështirësi në frymëmarrje dhe djersë të ftohta: nëse këto simptoma paraqiten para një udhëtimi tuaj me avion, atëherë vuani nga aerofobia. Po ja sesi mund ta kaloni me sukses këtë situatë:

1. Punoni mbi gjendjen shpirtërore dhe mbi pasojat që mund të gjeneroj ankthi. Shmangni konsumin e pijeve energjike që një ditë përpara udhëtimit, domethënë as kafe, as çaj. Gjithashtu ushqehuni jo shumë rëndë, por në mënyrë të ekuilibruar. Pushoni përpara se të niseni për aeroport, duke kaluar sidomos një natë të qetë dhe zgjim të kthjellët.

2. Mbërritja në aeroport duhet bërë me një farë avance, sepse kështu nuk do të rrezikoni t'i shton ankthit për fluturimin, edhe atë për "check in", për radhën dhe për kontrollet. Jepini vetes të kohën e duhur,



pasi kështu mund të keni mundësinë edhe të ambientoheni në aeroport e të ndiheni më të qetë. Përfitoni edhe për të bërë ndonjë shëtitje në ambient, duke u munduar të mbani mendjen diku tjetër, jo te fluturimi. Gjithashtu këshillohet të konsumoni edhe një qetësues natyral, si për shembull kamomil.

3. Në momentin e "check-in" kërkoni që në aeroplan të mos sistemoheni në një vend për krah dritares: tentativa për të shikuar poshtë do të jetë e pashmangshme dhe shikimi i botës nga lart mund t'ju frikësojë. Kur të ngjiteni në avion lexoni, apo dëgjoni muzikë, pra shpërqendrohuni e nëse ju vijnë mendime të këqija, largojini nga mendja me të gjitha forcat.

ANP-Kontrolli Ajror "Adem Jashari"

Vrellë, 10070 Lypjan,
Republika e Kosovës,
Tel:00381(0)38 59 59 274
anp-kontrolliajror@airportpristina.com